

20230971826

Në bazë të nenit 25 paragrafi 3 të Ligjit për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë në shkollat fillore dhe të mesme (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 161/19 dhe 229/20), ministri i Arsimit dhe Shkencës, miratoi

PROGRAMIN PËR TRAJNIM PËR AFTËSIMIN PROFESIONAL TË MËSIMDHËNËSVE PËR VITIN 2023

Neni 1

Me këtë program përcaktohen trajnimet për aftësimin profesional të mësimdhënësve në shkollat fillore dhe të mesme për vitin 2023.

Neni 2

Në kuadër të programit për trajnime për aftësimin profesional të mësimdhënësve për vitin 2023 bëjnë pjesë edhe programet e akredituara nga shtatori 2022.

Neni 3

Trajnimet për aftësimin profesional të mësimdhënësve në shkollat fillore dhe të mesme për vitin 2023 janë nga fushat, nënfushat dhe temat e mëposhtme të trajnimit:

I. SHKOLLAT FILLORE

Programet e akredituara për trajnim (shtator 2022 – shtator 2025)

1. Njohuri për lëndën mësimore dhe sistemin edukativo- arsimor

1.1. Njohuri për sistemin edukativo-arsimor

- Mësimi në distancë: aplikacionet e internetit dhe platformat e të mësuarit,
- Edukimi në një kontekst bashkëkohor: zhvillimi i aftësive socio-emocionale midis nxënësve,
- Multikulturalizmi në shkollat njëgjuhëshe dhe shumëgjuhëshe,
- Vetëvlerësimi i cilësisë së procesit arsimor në nivel shkolle dhe
- Barazia gjinore dhe ndjeshmëria gjinore në shkollë.

2. Mësimdhënia dhe të nxënit

2.1. Planifikimi dhe përgatitja e mësimdhënies

- Përfshirja dhe qasjet në mësimdhënien e nxënësve me nevoja/aftësi të veçanta arsimore.

2.2. Realizimi i mësimdhënies

- Aplikimi i qasjeve inovative ndërvepruese në mësimdhënie,
- Mësimdhënia e bazuar në një qasje të bazuar në problem,
- Të mësuarit përmes kërkimit, punës me projekte dhe zgjidhjes së problemeve,
- Mësimdhënia për zhvillimin e mendimit kritik të nxënësit dhe
- Mësimdhënia që synon arritjen e rezultateve të nxënit të nivelit më të lartë.

2.3. Vlerësimi i nxënësve

- Hartimi i testeve objektive të njohurive.

2.4. Njohja e nxënësve dhe plotësimi i nevojave të tyre

- Zhvillimi profesional dhe këshillimi në karrierë i nxënësve (mentorimi, monitorimi, qasjet për zbulimin e afiniteteve dhe interesave, motivimi dhe zhvillimi, etj.).

3. Krijimi i një mjedisi stimulues mësimor

3.1. Krijimi i një mjedisi mësimor të sigurt dhe stimulues

- Ballafaqimi me dhunën e bashkëmoshatarëve dhe bullizmin kibernetik dhe
- Zgjidhja e konflikteve me nxënësit dhe mes nxënësve.

3.2. Klima në shkollë

- Strategjitë e menaxhimit të klasës - parime dhe shembuj të praktikës së mirë për krijimin e një atmosfere pozitive pune në klasë dhe në klasën virtuale/ online.

4. Gjithëpërfshirja sociale dhe arsimore

- Strategjitë, metodat dhe teknikat për të punuar me nxënës të talentuar.

5. Zhvillimi profesional si dhe bashkëpunimi profesional

- Bashkëpunimi profesional i mësimdhënësve (aktivet profesionale, bashkësitë e të nxënësve, mentorimi, etj.).

Programe të trajnimit për shkollat fillore:

- Qasje udhëzuar për nxënësin për zhvillimin e kompetencave transversale (të menduarit kritik, sipërmarrja, kreativiteti dhe aktivizimi qytetar).

- Edukimi digjital - modernizimi i procesit arsimor për të nxitur kreativitetin dhe inovacionin tek nxënësit për pjesëmarrjen e tyre aktive në procesin edukativo -arsimor.

- Aftësitë, njohuritë dhe teknikat për parandalimin dhe reduktimin e sjelljeve të dhunshme dhe diskriminuese në mjedisin shkollor.

- Teknikat e të lexuarit me kuptim si një aftësi kryesore për të mësuarit e pavarur,

- Njohuri funksionale midis nxënësve - krijimi i asociacioneve dhe përmirësimi i njohurive të nxënësve,

- Strategjitë dhe mënyrat e trajtimit të sjelljeve të ndryshme të nxënësve në klasë dhe shkollë (vonesa në klasë; sjellje emocionale dhe e papërshtatshme - shkaqet dhe zgjidhjet),

- Monitorimi, vlerësimi dhe inkurajimi i përparimit të nxënësve dhe

- Zhvillimi i motivimit të brendshëm të nxënësit – se si mësimdhënësit mund t'i inkurajojnë nxënësit të vlerësojnë arritjet e tyre; si të inkurajohen nxënësit e painteresuar dhe të pamotivuar që ta ndryshojnë qëndrimin e tyre negativ për aftësitë dhe shkathtësitë e tyre.

II. SHKOLLAT E MESME

1. Njohuri për lëndën mësimore dhe për sistemin edukativ - arsimor

1.1. Njohuri për sistemin edukativo – arsimor

- Tendenca moderne arsimore - forcimi i njohurive të mësimdhënësve për parimet e përgjithshme të sistemit të edukimit dhe arsimit.

2. Mësimdhënia dhe nxënia

2.1. Planifikimi dhe përgatitja e mësimit

- Planifikimi i mësimit duke përdorur materiale didaktike elektronike në mësimdhënie dhe përdorimin e burimeve të TIK-ut,

- Metoda dhe teknika për një qasje të individualizuar në planifikimin e mësimit (zgjedhja e metodave të punës të përshtatshme për moshën, nevojat, interesat, njohuritë e ndryshme paraprake dhe stilet e të nxënësve të nxënësve)

2.2. Realizimi i mësimi

- Të lexuarit me kuptim, zhvillimi i të menduarit kritik të nxënësve dhe arritja e rezultateve të nxënësve të nivelit më të lartë dhe
- Strategjitë, metodat dhe teknikat e punës në një klasë gjithëpërfshirëse (inkluzive) dhe në ndërtimin e një shkolle gjithëpërfshirëse

2.3. Vlerësimi i nxënësve

- Monitorimi, vlerësimi dhe inkurajimi i përparimit të nxënësve dhe
- Avancimi i procesit të vlerësimit në arsimin profesional, vendosja e kritereve të qarta, harmonizuara dhe transparente të vlerësimit.

2.4. Njohja e nxënësve dhe plotësimi i nevojave të tyre

- Roli i mësimdhënësit në procesin e drejtimit dhe këshillimit të nxënësve në planifikimin dhe zhvillimin e aftësive transversale të rëndësishme për jetën dhe karrierën.
- Puberteti dhe adoleshenca - psikologjia e adoleshencës (njohja e nevojave dhe emocioneve).

3. Krijimi i një mjedisi mësimor stimules

3.1. Krijimi i një mjedisi mësimor të sigurt dhe stimules

- Mënyrat e parandalimit dhe përballjes së dhunës në shkollë dhe
- Krijimi i një mjedisi stimules për realizimin e mësimdhënies krijuese

3.2. Klima në shkollë

- Puna ekipore në shkollë dhe në klasë dhe
- Mbështetje për nxënësve që kanë vështirësi për të përparuar (mësim me moshatarët, mentorim, mësim shtesë).

4. Inkluzioni social dhe arsimor

- Qasje praktike në punën me nxënës me nevoja të veçanta arsimore (autizëm dhe ADHD) dhe
- Përmirësimi i aftësive mësimore të rëndësishme për përparimin e nxënësve të talentuar, përvetësimi i njohurive për nevojat specifike arsimore të nxënësve të talentuar, si dhe metodat dhe format e punës edukative me nxënës të talentuar.

5. Komunikimi dhe bashkëpunimi me familjen dhe komunitetin

- Komunikimi dhe bashkëpunimi efektiv me prindërit dhe komunitetet lokale, komunat, shoqatën e punëdhënësve dhe punëdhënësve individualë, organizatat/aktivitetet qytetare dhe partnerët e tjerë social dhe
- Format, fushat dhe mënyrat e bashkëpunimit me bashkësinë e biznesit në arsimin e mesëm profesional.

6. Zhvillimi profesional si dhe bashkëpunimi profesional

- Planifikimi i një plani personal për zhvillimin profesional të kuadri arsimor.

Neni 4

Ky program hyn në fuqi ditën vijuese nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nr. 18-4902/1
28.4.2023
Shkup

Ministër
i Arsimit dhe Shkencës,
Doc. dr **Jeton Shaqiri**, d.v.